



Nr. 16 Prot.  
Dt. 05/02/2020

## MARRËVESHJE BASHKEPUNIMI

Sot më datë 05/02/2020 në Selinë e Universitetit European të Tiranes, Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd. 70, H. 1, Tiranë, u paraqiten personalisht palët e mëposhtme:

**Shoqëria EUROPEAN EDUCATION INITIATIVE sh.p.k.**, person juridik i se drejtës shqiptare, me emër tregtar "UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS" Sh.p.k., regjistruar ne QKR me NIPT K62029010L, me seli ne adresen: Bulevardi "Gjergj Fishta" Tiranë, përfaqesuar nga Rektori, **Prof. Dr. Nevila NIKA**, (këtu e më poshtë referuar si UET);

dhe

**Shoqëria Kolegji Biznesi sh.p.k.**, person juridik i se drejtës Kosovare, themeluar me date 23.02.2004, me seli ne adresen: rruga "Motrat Qirjazi", nr. 29, Prishtine, përfaqesuar nga Rektori, **Prof. Shyqueri Kabashi**, (këtu e më poshtë referuar si Kolegji);

*Duke marre parasysh se:*

UET është një institucion jo-publik i arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, i themeluar në vitin 2006, regjistruar me vendimin nr. 36117, të datës 7 Korrik 2006, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe licensuar me vendimin nr. 636, datë 20.09.2006 të Keshillit te Ministrave, rikredituar me vendimin nr. 12, të datës 07 Prill 2017, për pesë vitet e ardhshme akademike (2017-2022) nga Agjencia ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë, "Agjencia e Sigurimit"). Universiteti UET ka për qëllim nder te tjera se: "a) të kryejë aktivitete mësimore dhe kërkimore, të kombinuara në mënyrë të integruar dhe në përputhje me planet mësimore të zbatuara; b) të kontribuojë në zhvillimin e arsimit universitar, kërkimin profesional dhe shkencor brenda vendit dhe ndërkombëtarisht; c) krijojë dhe mbajë mundësi për krijimin e një ambienti të favorshëm për studentin, në mënyrë që këta të fundit të mund të hyjnë në botën e punës dhe shkencore; d) promovimi i zbatimit të projekteve të ndryshme shkencore në fushën e arsimit universitar etj. ".

Në kushtet kur Arsimi i lartë në Republikën e Shqipërisë, si në të gjitha vendet e zhvilluara, konsiderohet si një shërbim dhe e mirë publike dhe realizohet në Universitete publike dhe jopublike dhe UET është shumë aktiv në hapësirën e arsimit të lartë dhe kërkimin shkencor si në Shqipëri ashtu dhe në arenën ndërkombëtare në nisma inovatore dhe zhvilluese, në botime akademike dhe shkencore, në projekte ndërinstitucionale, në tregun e punës ku ofron një garanci për studentët duke i paraprirë ndryshimeve të ndryshme që shfaq ekonomia e tregut;

Duke ekzistuar një gatishmëri reciproke për aktivizimin e një bashkëpunimi të frytshëm, në përbërjen sinergjike të përvojave dhe kompetencave përkatëse dhe me qëllim të realizimit të një sërë projektesh afatgjata;

Me angazhimin për të asistuar njëri-tjetrin mbi parimin e reciprocitetit dhe me bindjen se bashkëveprimi është në ndihmën dhe interesin e studentëve;



Në dritën e sa më sipër, Palët kanë vlerësuar pozitivisht mundësinë e bashkëpunimit për realizimin e qëllimeve të tyre institucionale;

Ateherë (kësishoj) Palët synojnë të rregullojnë me këtë memorandum, bashkëpunimin e tyre të vazhdueshëm, duke përcaktuar parimet e përgjithshme që do të qeverisin (udhëheqin) marrëdhëniet e tyre në kryerjen e aktiviteteve dhe gjithashtu duke përvjuar kontributet dhe angazhimet e tyre përkatëse:

*Duke rënë dakort si më poshtë vijon:*

**Neni 1**  
**OBJEKTI I MEMORANDUMIT**

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi (më poshtë "Marrëveshja") ka për objekt përcaktimin e rregullave dhe modaliteteve brenda të cilave Palët do të zhvillojnë, marrëdhëniet ndërmjet tyre, për arritjen e objektivave të përbashkët.

**Neni 2**  
**QËLLIMI**

Qëllimi i kësaj Marrëveshje është zhvillimi i bashkëpunimit akademik në nivelin e studimeve universitare, si dhe zhvillimi i aktiviteteve kërkimore, shkencore dhe kulturore ndërmjet dy Universiteteve, me konkretisht por pa u kufizuar në to:

- A. UET do të japë kontributin për zhvillimin e arsimit universitar, kërkimin profesional dhe shkencor, pjesmarrjen në aktivitete, në trajnimin e stafit, aplikimin në projekte, por pa u kufizuar këtu, Kolegit.;
- B. UET do të zhvillojë/ofrojë programe aftësimi të stafit, praktika, klinika të mësuarit, etj Kolegit;
- C. UET do të asistojë/trajnojë/ofrojë Kolegit asistencën përkatëse lidhur me akreditimin e këtij institucioni si dhe do të hartojë të gjitha politikat, planet, aktet përkatëse përmirësimin e kuadrit rregullues si dhe cdo procedurë tjetër të nevojshme lidhur me këtë interes;
- Ç. Palët do të bashkëpunojnë në projekte kombetare dhe ndërkombetare në fushat objekt veprimtarie të palëve dhe bashkëpuntorëve të tyre të ngushtë. Për më tepër, format e bashkëpunimit do të realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare dhe evropiane, të realizuara nga UET dhe ose Kolegji nëpërmjet mbështetjes së UET;
- D. Realizimi i konferencave shkencore, aktiviteteve dhe projekteve që kanë për qëllim kërkimin;
- E. Kooperimi dhe bashkëpunimi me persona juridik fitimprures ose jo fitimprures pjesë e grupeve përkatëse.

Këto nisma do të zhvillohen në bashkëpunim dhe do të dakordësohen në marrëveshjet përkatëse të veprimit.

**Neni 3**  
**ANGAZHIMET E PALËVE DHE FORMAT E BASHKËPUNIMIT**

Bashkëpunimi mbështetet mbi bazën e parimeve demokratike dhe në pajtim me autonominë dhe lirinë akademike të të dyja palëve.

Palët bien dakord mbi realizimin e projekteve kërkimore, trajnimit dhe aktiviteteve të arsimit të lartë, iniciativave që kanë për qëllim rritjen e rezultateve të aktiviteteve dhe çdo aktivitet tjetër me interes të përbashkët, nëpërmjet përcaktimit të marrëveshjeve përkatëse/protokolleve të veçanta. Çdo Marrëveshje e mëpasshme, e cila duhet të jetë në përputhje me këtë Marrëveshje Kuadër dhe legjislacionin përkatës që rregullon fushën e secilës palë, duhet të miratohet nga Palët.



Marrëveshjet e veprimit do të rregullojnë procedurat sipas të cilave do të zbatohet bashkëpunimi midis palëve, duke specifikuar në veçanti aspektet e natyrës teknike, organizative, menaxheriale dhe financiare.

#### Neni 4

#### DETÝRIMET/PAGESA

Kjo Marrëveshje kornizë nuk i ngarkohet palëve në vlera monetare. Pagesat dhe ose tarifat që do të lindin lidhur me zhyllimin / implementimin të e një ose disa pika të përcatuara në nenin 2 të kësaj Marrëveshje do te jën subjekt tarife/pagesese e cila do të përcaktohet në marrëveshjet individuale të operimit.

#### Neni 5

#### KONFIDENCIALITETI – PRONËSIA INTELEKTUALE

Palët Jane reciprocikisht të detyruar lidhur me konfidencialitetin përsa i përket, informacionit, të dhënat dhe njohuritë që do të shkëmbehen gjatë vlefshmërisë dhe / ose ekzekutimit të kësaj Marreveshje dhe marrëveshjeve përkatëse/protokolleve të veçanta, me përjashtim të atij informacioni, të dhënavë, lajme dhe vendime për të cilat ligji ose një dispozitë administrative ose gjyqësore imponon një detyrim komunikimit dhe / ose nëse jepet pëlqimi i Palës nga e cili rrjedhin këto të dhëna.

Çdo e drejtë ë pronësisë intelektuale e mbajtur nga një Palë do të mbetet në pronësinë e saj të plotë dhe përdorimi i saj që mund t'u lejohet Palës tjeter në kontekstin e kësaj Marrëveshje por nuk do të nënkuptojoë njohjen e ndonjë licence apo të drejte, përvèç në rastet kur transferimi i një licence ose të drejte të tillë është parashikuar shprehimisht nga Marrëveshjet përkësëse.

#### Neni 6

#### TË DREJTAT DHE DETÝRIMET E PALEVË

Palët i përbahen politikave të mundësive të barabarta dhe nuk diskriminojnë mbi baza racore, të ngjyrës, moshës, etnive, fetare, paaftësive, origjinës kombëtare apo orientimeve seksuale.

Palët bien dakort që bashkëpunimi i tyre do të respektoje dhe nuk do te cenoje aktet ligjore dhe nënligjore, mbi të cilën funksionojnë palët si dhe praktikat e mira, traditë e tyre.

Palët do të nxisin njëra tjetrën për një bashkëpunim sa më të gjëre dhe intensiv duke eksploruar fusha të reja bashkëpunimi dhe duke forcuar ato aktuale. Iniciativava "të tjera" do të zhvillohen në konsultim midis universiteteve dhe do të negociohen dhe do të nënshkruhen me Marrëveshje përkatëse me shkrim nga dyja palët.

Palët marrin përsipër që të vendosin në dizpozicion të njëra tjetës të gjitha burimet njerëzore dhe materiale për aritjen e qëllimeve që parashikon ky memorandum.

#### Neni 7

#### INTERPRETIMET

Palët do të interpretojnë çdo pikë të këtij Memorandumi duke mare parasysh vullnetin dhe dëshirën e mirë që i ka sjellë palët deri në nënshkrimin e këtij memorandumi.

Ky memorandum nuk mund të jetë pjesë e ndonje konflikti gjyqesor dhe palet çdo keqkuptim që mund të lindë nga interpretimi i tij do ta zgjidhin me mirëkuptim ose ndërmjetësim.

#### Neni 8

#### DISPOZITA TË FUNDIT



Kjo Marrëveshje bashkëpunimi lidhet për një periudhë pesë vjeçare që nga data e nënshkrimit të saj nga të dyja palët me mundësi rinosimi.

Çdo palë mund të kërkojë zgjidhjen e marrëveshjes, duke njoftuar me shkrim palën tjetër 6 muaj më parë. Mungesa e shkëmbimeve gjatë çdo viti kalendarik është e mundur dhe nuk anulon këtë marrëveshje.

Të dy institucionet mund ta rishikojnë marrëveshjen duke ndërmarrë veprimet e duhura. Të gjitha modifikimet duhet të bëhen me shkrim dhe duhet të miratohen zyrtarisht nga të dy institucionet.

Palët në këtë Marrëveshje Bashkëpunimi do të bëjnë të gjitha përpjekjet për ekzekutimin sa më efektiv të të gjitha detyrimeve të marra përsipër prej tyre.

Kjo marrëveshje hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj.

Memorandumi përpilohet në gjuhën shqipe në 4 (katër) kopje me vlerë të njejtë ligjore ku secila palë merr dy prej tyre.

Ky memorandum përbën marrëveshjen e plotë ndërmjet palëve, të cilat, pasi e lexojnë dhe pasi gjejnë të shprehur në të, vullnetin e tyre të lirë dhe të plotë, e nënshkruajnë atë rregullisht për të gjitha efektet e ligjit.

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u nënshkrua sot, më datë 05.02/2020.

#### PALËT


Universiteti European i Tiranës

Prof. Dr. Nevila NIKA



Shoqëria Kolegji Biznesi sh.p.k

Prof. Shyqyri KABASHI





## ANEKS

Sot më datë 05.02.2020 në Selinë e Universitetit European të Tiranes, Bulevardi "Gjergj Fishta", Nd. 70, H. 1, Tiranë, lidhet aneksi me permbajtjen e meposhtme:

### Universiteti european i Tiranes (UET) dhe Kolegji i Biznesit (Kolegji):

Palet e lartpermendura bien dakort:

Ne kushtet kur palët e mësipërme kanë nënshkruar memorandumin e bashkëpunimit me datë 05.02.2020, atëherë bazuar në nenin 2 dhe 5 të kësaj marrëveshje dakortësohen për kushtët e mëposhtme:  
Kolegji kontraktion UET për zhvillimin e projektit sipas njërsë ose disa prej pikave të mëposhtme, kundrejt pagesës në shumën prej *rast pas rasti*.

- i. *UET do të japë kontributin për zhvillimin e arsimit universitar, kërkimin profesional dhe shkencor, pjesmarrjen në aktivitete, në trajnimin e stafit, aplikimin në projekte, por pa u kufizuar këtu, Kolegji; ;*
- ii. *UET do të zhvillojë/ofrojë programe aftësimi të stafit, praktika, klinika të mësuarit, etj Kolegji;*
- iii. *UET do të asistojë/trajnojë/ofrojë Kolegjet asistencën përkatëse lidhur me akreditimin e këtij institucionisë si dhe do të hartojë të gjitha politikat, planet, aktet përkatëse për përmirësimin e kuadrit rregullues si dhe cdo procedurë tjetër të nevojshme lidhur me këtë interes;*
- iv. *Palët do të bashkëpunojnë në projekte kombetare dhe ndërkombetare në fushat objekt veprimtarie të palëve dhe bashkëpuntorëve të tyre të ngushtë. Për më tepër, format e bashkëpunimit do të realizohet nëpërmjet pjesëmarrjes në projekte ndërkombëtare dhe evropiane, të realizuara nga UET dhe ose Kolegji nëpërmjet mbështetjes së UET;*
- v. *Realizimi i konferencave shkencore, aktiviteteve dhe projekteve që kanë për qëllim kërkimin;*
- vi. *Kooperimi dhe bashkëpunimi me persona juridik fitimprures ose jo fitimprures pjesë e grupeve përkatëse.*

## PALËT

Universiteti European i Tiranës

Prof. Dr. Nevila NIKA



Shoqëria Kolegji Biznesi sh.p.k

Prof. Shyqyri KABASHI

